



**Data: 16/09/2024**

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL  
PROCEDURË E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR  
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “IMPLEMENTIMI I QENDERZUAR I INFRASTRUKTURES  
THIN CLIENT (VDI)”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Sisteme  
informacioni dhe servera 48800000-6

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 45,000,000 (Dyzet e pesëmilion) Lek, pa TVSH ose 452,397 (Katerqind e pesëdhjetë e dymije e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSH.

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 16/09/2024 është  
99.47Lekë/Euro***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

### **Argumentimi:**

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP, i ndryshuar, “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):** me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit.

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 27001:2022 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë informatike”
- b) BS PAS 99:2012 “Sistemi i menaxhimit të integruar”
- c) ISO 2000-1:2018 “Sistemi i menaxhimit të shërbimeve”

### **Argumentimi:**

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".


**ISO 27001:2022 "Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit"** - Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurt dhe të mos cenohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike.

**BS PAS 99:2012 "Sistemi i menaxhimit të integruar"** - Duke qenë se dy nyje të reja fizike do të shtohen në infrastrukturën ekzistuese VxRail që zotëron të dhëna sensitive dhe konfidenciale, të ekspozuara para një numri të madh përdoruesish, nevojitet siguria dhe eksperiencia e dokumentuar në menaxhimin e këtij projekti. BS PAS 99:2012 tregon që operatori ekonomik punon sipas standardeve të ndryshme botërore të implementuara nga sisteme menaxhuese të ndryshme që ai ka implementuar dhe ka aftësi optimizuese për të gjitha sistemet e menaxhimit me të cilat punon në funksion të ofrimit të shërbimeve sa më efikase dhe profesionale.

**ISO 20000-1:2018 "Sistemi i menaxhimit të shërbimeve"** - Duke qenë se projekti përfshin kryerjen e shërbimeve të instalimit, konfigurimeve dhe implementimit të një infrastrukture IT, nevojitet dëshmi e zotërimit të aftësive të nevojshme sipas standardeve ndërkombëtare. Standardi ISO/IEC 20000-1:2018 tregon që operatori ekonomik është në gjendje të identifikojë dhe menaxhojë proceset kryesore që lidhen me ofrimin efikas të shërbimeve të teknologjisë së informacionit për të përmbushur nevojat e biznesit të institucionit

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar të paktën 10(dhjetë) punonjës.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:**

 Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Qershor 2024 – Gusht 2024

#### **Argumentimi:**

Kërkesat për punonjësit janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka staf të mjaftueshëm për të siguruar ekzekutimin e kontratës gjatë gjithë fazës së implementimit të projektit. Gjatë projektit do të identifikohen kërkesa më specifike për ngritjen e makinave virtuale me konfigurimin e përshtatshëm sipas nevojave për të hostuar aplikacione të ndryshme të Korporatës.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjësit të cilët të jenë të certifikuar si më poshtë:

- ✚ Minimalisht 1(një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT me certifikatë ITIL ose ekuivalente.
- ✚ Minimalisht 2(dy) punonjës të certifikuar në teknologjinë e virtualizimit të datacenter-it, nivel profesional ose ekuivalent.
- ✚ Minimalisht 2(dy) punonjës të certifikuar për implementimin dhe administrimin e infrastrukturës të konvergjuar ose ekuivalent.
- ✚ Minimalisht 2(dy) punonjës të certifikuar për implementim të infrastrukturave të tipit VDI.

**Sqarim:**

***Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certificate.***

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

- Kontratë pune të vlefshme;
- Çertifikatat e mësipërme të vlefshme;
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Qershor 2024 – Gusht 2024.

**Argumentimi:** Kërkesat për punonjësit janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Në lidhje me punonjësit, argumentojmë si më poshtë:

Punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT me certifikatë ITIL ose ekuivalente. Ky punonjës është i domosdoshëm për të siguruar mbarëvajtjen e kontratës nga aspekti i menaxhimit të shërbimeve IT të parashikuara. Për këtë arsye është e domosdoshme një ndjekje rigoroze bazuar në metodologjinë botërore, prandaj operatori ekonomik duhet të vërë në dispozicion të kontratës një punonjës të certifikuar për menaxhim shërbimesh.

Punonjës të certifikuar në teknologjinë e virtualizimit të datacenter-it, nivel profesional ose ekuivalent. Këta punonjës janë të domosdoshëm për të siguruar implementimin në kohë dhe me cilësi të lartë të infrastrukturës në datacenter, bazuar mbi teknologjinë e kërkuar të virtualizimit.

Punonjës të certifikuar për implementimin dhe administrimin e infrastrukturës së konvergjuar ose ekuivalent. Këta punonjës janë të domosdoshëm për të siguruar implementimin në kohë dhe me cilësi të lartë të infrastrukturës Hardware të Mbikonvergjuar. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka staf të mjaftueshëm për të siguruar ekzekutimin e kontratës gjatë gjithë fazës së implementimit të projektit.

Serverat virtualë që do të konfigurohen mbi infrastrukturën e konvergjuar hardware do të duhet të mbështesin desktop virtual me sistem Windows 10, Windows 11, Windows Server 2012 R2/2016/2019/2022. Shtresa baze e implementimit të sistemeve aplikative është sistemi operativ në serverat ku do të ngrihen dhe ekzekutohen aplikacionet. Për këtë qëllim është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij specialistë me këto aftësi të demonstruara nëpërmjet certifikimit të kërkuar gjatë gjithë periudhës së implementimit të kontratës.

Duke qenë se objekt i projektit është ndërtimi i një infrastrukture VDI (Virtual Desktop Infrastructure) kërkohet staf i specializuar për të tilla infrastrukture dhe kjo ekspertizë kërkohet që të provohet me certifikime që dëshmojnë njohuritë për implementime të tilla.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për pajisjet dhe shërbimet që do të ofrojë.

*Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.*

### **Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kërkesat e mësipërme na garantojnë që operatori ekonomik është në gjendje të ofrojë produktet e kërkuara drejtpërdrejt nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, si dhe prodhuesi i pajisjeve është i angazhuar me përgjegjësi të plota për të siguruar cilësinë dhe performancën gjatë periudhës së garancisë.

*Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

**Shënim:** Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".

**Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.**

### **I. Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Ky projekt konsiston në zgjerimin e infrastrukturës aktuale VxRail me 2 nyje të reja fizike dhe ndërtimin e një infrastrukture të re të qendërzuar "Virtual Desktop" që përfshin zëvendësimin e

një pjese të pajisjeve PC me teknologji të qendëruar Virtual Desktop Infrastructure (VDI), duke realizuar objektivat e mëposhtëm:

Furnizimin dhe instalimin e 2 nyjeve të reja fizike dhe licencave përkatëse pjesë e zgjerimit të infrastrukturës ekzistuese VxRail.

Furnizimin dhe instalimin e pajisjeve hardware Thin Client dhe aksesorët përkatës.

Instalimet dhe konfigurimet e infrastrukturës VDI në serverat e rinj që do të jenë pjesë e zgjerimit të infrastrukturës ekzistuese VxRail.

Furnizimin e të gjitha licencave të nevojshme për platformën VDI në mënyrë që kjo zgjidhje të jetë funksionale në tërësi të saj.

Për ndërtimin e dokumentit të specifikimeve teknike janë zbatuar praktikat standarde të teknologjisë së informacionit dhe virtualizimit, duke kërkuar të ofrohen pajisje server me performancë të lartë dhe me komponentë të integruar duke shmangur ndarjen e sistemeve server në komponentë të ndryshëm. Sistemi kërkohet të zhvillohet me topologjinë hyper-converged ku të gjitha shërbimet të vendosen në këto servera të cilat ndajnë performancën midis tyre për të garantuar disponueshmëri dhe ruajtje të shërbimit.

### **Njësia e Prokurimit**